



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
*Sesioni pranveror*

**Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**  
**Mbledhja nr. 14**  
**Prishtinë, 23.04.2018, në orën 11:00**  
**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303**

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Igor Simić- kryetar i Komisionit, Xhelal Sveçla- zëvendëskryetar i parë , Danush Ademi -zëvendëskryetar i dytë , Kujtim Shala, Fadil Beka, Haxhi Shala, Zoran Mojsilović, Jasmina Zhivković, Sasha Milosavljević, Rasim Selmanaj, Slobodan Petrović, anëtarë.

Munguan: Albert Kinolli, Mufera Srbica-Sinik, Duda Balje dhe Veton Berisha.

Nga pjesëmarrësit tjerë: Senad Karaahmetović -pëfaqësues i OSBE-së; mediat e RTK-së dhe Kosova Press; Zijush Ahmeti, këshilltar i Sekretariatit të KKK-së dhe Celal Iliaz, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Stafi për mbështetje të Komisionit: koordinatorë- Natasa Prica- Tišma dhe Drita Çarkaxhiu -zyrtarë e lartë e fushës.

Mbledhjen e kryesoi: kryetar i Komisionit, Igor Simić.

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet embajtura më 27.03.2018 dhe 30.03.2018;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-012 për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën, me amendamentet e Komisionit funksional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-001 për ndryshimin dhe plotësimin të Ligjit nr. 02/L-31 për Liritë Fetare në Kosovë, me amendamentet e Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione;**
- 5. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

**Kryetari**, konstatoi se rendi i ditës miratohet njëzëri, pa ndryshime.

## **2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 27.03.2018 dhe 30.03.2018;**

### **2.a Miratimi i procesverbalit të datës 27.03.2018.**

**Kryetari**, Lidhur me miratimin e procesverbalit të datës 27.03.2018, sipas mendimit tim, mbledhja e komisionit nuk është caktuar në pajtim me ligj, sepse unë si kryetar i komisionit nuk kam qenë i informuar. Unë në mbledhje të kaluar kam kërkuar që të parashtrohet kërkesë e 1/3 anëtarëve të komisionit për mbajtjen e mbledhjes, por të njëjtin nuk e kam marrë, por vetëm listën me nënshkrimet e anëtarëve të pranishëm të komisionit.

Konsideroj që kjo nuk është në rregull, prandaj unë nuk do të votoj për miratimin e këtij procesverbali dhe nuk do të kërkojë rishqyrtimin e kushtetutshmërisë së vendimit të komisionit për shqyrtimin e këtyre ligjeve me procedurë të përshpejtuar, të cilët ishin në rend të ditës, por diçka e tillë nuk duhet të përsëritet. Për këtë arsye do të votojmë ndaras për këto dy procesverbale.

*Pas vërejtjes së kryetarit, ai hodhi në votim procesverbalin e mbledhjes së mbajtur me datë 27.03.2018 dhe i njëjti u miratua me shumicë votash: 6 Për, 5 Kundër.*

### **2.b Miratimi i procesverbalit të datës 30.03.2018**

**Kryetari**, konstatoi se miratohet procesverbali i mbledhjes së Komisioni të mbajtur më: 30.10.2017, pa vërejtje.

## **3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-012 për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën, me amendamentet e Komisionit funksional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Meqenëse nuk kishte vërejtje dhe diskutime lidhur me këtë Projektligj dhe amendamentet e propozuara, Komisioni nxori këtë:

### **Përfundim**

Komisioni me shumicë të votave 7 Për, 4 kundër, konstatoi se Projektligjit nr.06/L-012 për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën, me amendamentet e Komisionit funksional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media nuk shkel dhe cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve, kështu që rekomandohet miratimi i tij në shqyrtim të dytë. Përfaqësuesit e GP Lista serbe votuan kundër miratimit të këtij Projektligji dhe amendamenteve të propozuara, me konstatim se i njëjti shkelë dhe cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve

## **4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-001 për ndryshimin dhe plotësimin të Ligjit nr. 02/L-31 për Liritë Fetare në Kosovë, me amendamentet e Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione;**

**Kryetari**, theksoi se janë duke vazhduar praktika që amendamentet e GP Lista serbe, për çfarëdo arsye refuzohen, madje edhe ato që i takojnë kategorisë teknike të amendamenteve, përkatësisht të amendamenteve që përkthehen, ngase përkthimi i versioneve në tri gjuhë dallojnë.

Duhet theksuar se në bazë të nenit 81 të Kushtetutës, për miratimin e ligjeve në Kuvend, të cilat janë me interes vital, siç është edhe Ligji për liritë fetare, janë të domosdoshme votat e komuniteteve joshumice. Duke marrë parasysh se komisioni funksional nuk e ka miratuar asnjë amendament të Listës serbe, ne nuk do të votojmë për këtë Projektligj në Komision e as në Kuvend.

Lidhur me këtë ekziston edhe një çështje e rëndësishme ngase ky Ligj ka lidhje me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore, amendamenti 12 i komisionit funksional. Ky formulim nuk qëndron në ligjin bazik, prandaj kërkon rishqyrtim shtesë. Për komunitetin serb ky ligj është i rëndësishëm së veçantë dhe ka të bëjë me kishën tonë. Ne si përfaqësues politik nuk kemi dashur që ta politizojmë këtë çështje, ngase ky është minimum i minimumit dhe si jurist mund të them se ky ligj i është i hartuar në mënyrë groteske.

**Kujtim Shala**, ky Projektligj është hartuar në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Kosovës, si dhe në bazë të standardeve për të drejtat dhe liritë e njeriut, që janë të rregulluara me deklaratat dhe konventave ndërkombëtare.

Fushëveprimi duhet të jetë i kufizuar në çështjet që kanë të bëjnë me statusin e bashkësive fetare në Kosovë. Bashkësitë fetare janë të lira për përcaktimin e identitetit të tyre fetar dhe ta zhvillojnë organizimin fetar në mënyrë të pavarur.

Me rastin e shqyrtimit të amendamenteve të komisionit funksional dhe amendamenteve të paraqitura nga GP Lista serbe duhet të jemi të kujdesshëm, sepse në qoftë se përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë votojnë kundër këtij Projektligji në Kuvend, Ligji sërish do të kthehet në fillim.

Çështjet që kanë të bëjnë me trashëgimi kulturore janë të rregulluar me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore dhe përfshijnë çështjet materiale, arkeologjike dhe arkitektonike të një shoqërie, që trashëgohen, mbrohen dhe i barten gjeneratave të ardhshme, ndërsa çështjet që kanë të bëjnë me liritë fetare janë të ndara.

Pas diskutimeve, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë:

### **Përfundim**

Komisioni me shumicë të votave 6 Për, 4 Kundër dhe 1 Abstenim, konstatoi se Projektligji nr.06/L-001 për ndryshimin dhe plotësimin të Ligjit nr. 02/L-31 për Liritë Fetare në Kosovë, me amendamentet e Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione nuk shkel dhe cenontë drejtat dhe interesat e komuniteteve, kështu që rekomandohet miratimi i tij në shqyrtim të dytë.

Përfaqësuesit e GP Lista serbe votuan kundër miratimit të këtij Projektligji dhe amendamenteve të propozuara, me konstatim se i njëjti shkelë dhe cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

*Mbledhja përfundoi në orën 11:45.*

*Përgaditur nga stafi mbështetës i Komisionit*

**Kryetari i Komisionit**

---

**Igor Simić**